

VENDIM
Nr. 129, datë 25.6.2024

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 17, DATË 6.2.2024, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË ‘ERSEKA SOLAR PARK 1’ SHPK, PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT TË ERE-s, PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SAJ SI KOLATERAL PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.6.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 54/11 prot., datë 21.6.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 17, datë 6.2.2024, ‘Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Erseka Solar Park 1’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s, për vendosjen e kuotave të saj si kolateral për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 17, datë 6.2.2024, ka vendosur dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. si mjet (kolateral) për garantimin e përmbushjes së detyrimeve të saj, për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj palës kredidhënëse (Banka e Parë e Investimeve - Albania sh.a. dhe First Investment Bank AD, Sofie Bullgari).

- Në pikën 3 të këtij vendimi i është lënë kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj.

- Pas korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, në lidhje me plotësimin e këtij kushti, rezultoi se ajo ka depozituar në ERE dokumentacion përkatës ndaj vlerësohet që kjo pikë e vendimit të shfuqizohet.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 17/2024, shfuqizohet.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti